



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Raporti i përmbushjes së obligimeve të komunave
nga Agjenda Evropiane për periudhën
Janar – Dhjetor 2025



Prishtinë, 2026

Përmbajtja

Shkurtesat	3
Hyrje	4
Përmbledhje Ekzekutive.....	5
1. KRITERET POLITIKE	7
1.1 Administrata Publike	7
1.2 Shoqëria civile	9
1.3 Lufta kundër korrupsionit dhe kundër terrorizmit	9
1.4 Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore	11
2. KRITERET EKONOMIKE	12
2.1 Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut.....	12
2.2 Tatimet	13
2.3 Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë	14
3. STANDARDET EVROPIANE.....	14
3.1 Bujqësia dhe zhvillimi rurale	14
3.2 Energjia	15
3.3 Gjqësori dhe të drejtat themelore	16
3.4 Mbrojtja e minoriteteve.....	20
3.5 Drejtësia, liria dhe siguria	21
3.6 Menaxhimi i kufirit dhe migracioni	21
3.7 ARSIMI DHE KULTURA.....	22
3.8 Mjedisi.....	23
3.9 Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik.....	24
REKOMANDIMET.....	25

Shkurtesat

BE	Bashkimi Evropian
EVS	Ekipet Vepruese për Siguri
KE	Komisioni Evropian
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
KLSP	Këshillat Lokale për Siguri Publike
MAPL	Ministria e Pushtetit Lokal
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
OJQ	Organizata joqeveritare
PKIE	Programi Kombëtar për Integrim Evropian

Hyrje

Ky raport paraqet implementimin e obligimeve të komunave, që burojnë nga Agjenda Evropiane gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025. Duke pasur parasysh se Programi Kombëtar i Zbatimit të MSA është dokument ligjërish i detyrueshëm për të gjitha Institucionet e Kosovës, Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal është e përkushtuar në përmbushjen e obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane.

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve, MAPL ka zhvilluar disa mënyra të adresimit të çështjeve në nivel lokal për të shtyrë para agjendën evropiane, duke veçuar: koordinimin e procesit të planifikimit, hartimin e planit të përgjithshme për obligimet e komunave në procesin e integritit evropian, hartimin e planeve individuale të komunave si dhe hartimin e raportit të përmbushjes së obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar – Dhjetor 2025.

Raporti ka rol të rëndësishëm dhe domethënës mbi zhvillimin e aktiviteteve të nivelit lokal në fushën e Integritit Evropian, marrë parasysh përgjegjësinë që kanë komunat në raport me qytetarët dhe institucionet publike. Qëllimi i këtij raporti është prezantimi dhe ofrimi i të dhënave të komunave për qytetarët, institucionet vendore dhe ndërkombëtare, organizatat joqeveritare si dhe çdo grupi tjetër të interesit, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Bashkimi Evropian.

Përmbledhje Ekzekutive

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025 kanë raportuar 32 komuna të Republikës së Kosovës, ndërsa 6 komuna (Ferizaj, Graçanicë, Kllokot, Mitrovicë Veri, Zubin Potok, Leposaviq) gjatë kësaj periudhe nuk kanë raportuar. Raporti është i bazuar në 43 objektiva dhe 131 pyetje/indikator që bien në përgjegjësi dhe kompetencë të komunave, për të cilat Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar veprime konkrete nga komunat. MAPL në komuna ka adresuar të gjitha çështjet që burojnë nga Plani Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE), nga konkluzionet e nën komiteteve sektoriale si dhe nga sfidat e raportit të KE-së për Kosovën. Sa i përket strukturës së gjithmbarshme, raporti përqendrohet në fushat kryesore të aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me kriteret politike, kriteret ekonomike, standardet evropiane si dhe raporti pasqyron gjendjen reale të arriturave të komunave, por njëkohësisht edhe të sfidave për vitet në vijim.

Në kuadër të **kritereve politike** prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Administrata publike,
- Avokati i popullit,
- Shoqëria civile,
- Lufta kundër terrorizmit,
- Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore.

Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përbushin përafërsisht **64.2%** të aktiviteteve të planifikuara në fushën e kritereve politike.

Në kuadër të **kritereve ekonomike** prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut.
- Tatimet,
- Ndërmarrjet, politikat e industrisë.

Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përbushin përafërsisht **71.3%** të aktiviteteve të planifikuara në fushën e kritereve ekonomike.


Në kuadër të **standardeve evropiane**, prezantohet arritja e nivelit lokal në fushat:

- Bujqësi dhe zhvillimi rural,
- Energji,
- Gjyqësori dhe të drejtat themelore
- Mbrojtja e minoriteteve,
- Drejtësia, Liria dhe siguria,
- Menaxhimi i kufirit dhe migracioni,

- Arsimi dhe Kultura,
- Mjedisi
- Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik.

Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin përafërsisht **65% të** aktiviteteve të planifikuara në fushën e standardeve evropiane.

Në total komunat kanë arritur t'i përmbushin përafërsisht **67% të** obligimeve që burojnë nga Agjenda Evropiane, e që bien nën përgjegjësinë e implementimit të qeverisjes lokale.



Grafikoni 1: Përmbushja e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane

1. KRITERET POLITIKE


1.1 Administrata Publike

Një nga fushat kryesore që bënë pjesë në kuadër të kriteve politike është funksionimi i administratës publike lokale. Në kuadër të kësaj fushe, komunat e Republikës së Kosovës kanë ndërmarr aktivitete lidhur me sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për administratën lokale, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarë, rritjen e efikasitetit dhe transparencës, si dhe ndërtimin e mekanizmave më efikas të llogaridhënies në raport me qytetarët.

Në kuadër të masave për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, Në 29 komuna (Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjiilan, Glogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Kamenicë) kanë hartuar programin e trajnimeve për vitin 2025, ndërsa 3 komuna (Pejë, Ranillug, Zveçan) nuk e kanë hartuar këtë program për periudhën raportuese.

Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të kornizës së politikave në fushën e administratës, në pasqyrën e të dhënave të komunave mund të shohim se nga 32 komuna raportuese janë 16 komuna që kanë hartuar Strategjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun për periudhën raportuese: Deçan, Junik, Gjiilan, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malisheve, Obiliq, Podujevë, Prizren, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Suharekë.

Në 16 komuna nuk është hartuar Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun për periudhën raportuese: Dragash, Fushë Kosovë, Glogoc, Gjakovë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Partesh, Pejë, Prishtinë, Ranillug, Shtërpcë, Viti, Vushtrri, Zveçan, Kamenicë.



Grafikoni 2: Programit i trajnimeve dhe Strategjia për Komunikim me Publikun

Po ashtu planin vjetor të komunikimit deri më tani e kanë hartuar 21 komuna për periudhën raportuese: Deçan; Junik; Gjilan; Glogoc, Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mitrovicë e Jugut; Obiliq; Podujevë; Prizren; Rahovec; Shtime; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë.

Në 11 komuna nuk e kanë hartuar Planin vjetor të komunikimit për periudhën raportuese: Dragash; Fushë Kosovë; Mamushë; Novobërdë; Partesh; Pejë; Prishtinë; Ranillug; Shtërpçë; Skenderaj; Zveçan.

Sa i përket zbatimit të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për standardet minimale të konsultimit publik, janë Në 32 komuna po zbatohet Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për standardet minimale të konsultimit publik: Deçan; Dragash; Fushë Kosovë; Junik; Gjilan; Glogoc (Drenas); Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Pejë; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Rahovec; Ranillug; Shtime; Shtërpçë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Zveçan; Kamenicë. Mirëpo nëse shohim të dhënat e paraqitura në vijim mund të vërejmë që akoma nuk zbatohen dispozitat e U.A në nivel të duhur pasi që rezultatet e konsultimit publik me raportin e të gjitha propozimeve të ofruara nga qytetarët me sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve tjera të interesit publikohen në një numër të konsiderueshëm të Komunave.

Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për standardet minimale të konsultimit përcakton se në çdo komunë, përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është njësi/zyrtari për komunikim publik, në përputhje me këtë deri më tani Në 27 komuna është caktuar zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik: Deçan; Dragash; Junik; Gjilan; Glogoc, Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Rahovec; Shtime; Shtërpçë; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë.

Në 5 komuna nuk është caktuar zyrtari përgjegjës për këtë proces: Fushë Kosovë; Pejë; Ranillug; Skenderaj; Zveçan.

1.2 Shoqëria civile

Nga të dhënat e ofruara gjatë raportimit shohim se komunat në vazhdimësi kanë përkrahur shoqërinë civile duke i ofruar mbështetje dhe bashkëpunim. Nga të dhënat e pranuar një numër i konsiderueshëm i komunave kanë ofruar mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve. Në 30 komuna (Deçan; Dragash; Fushë Kosovë; Junik; Gjiilan; Glllogoc, Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Pejë; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Rahovec; Ranillug; Shtime; Shtërpçë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë.) buxheti i ndarë për mbështetjen e projekteve të OSHC-ve konform Rregullores 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publikë të OJQ-ve është 11,747,704.06€, ndërsa në 2 Komuna (Mamushë, Zveçan) nuk ka ndarë buxhet. Me këtë mbështetje financiare janë përkrahur 866 OJQ me projekte.

Për nxitjen dhe stimulimin e aplikimit të OJQ-ve në projekte komunale komunat kanë ndërmarr edhe veprime si: informimi në radio lokale, rrjete sociale dhe thirrje në ueb faqe të komunave, organizime të takimeve informuese për procedurat e aplikimit, ofrimi i ndihmës në plotësimin e dokumentacionit aplikues për gupet e OJQ-ve të cilat janë të marginalizuara, etj. Komunat gjithashtu kanë përkrahur edhe projekte të OJQ-ve për mbrojtjen e komuniteteve pakicë. Në 18 Komuna (Dragash; Fushë Kosovë; Gjiilan; Gjakovë; Istog; Malishevë; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Pejë; Prishtinë; Prizren; Shtime; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë), janë përkrahur 142 projekte të OJQ-ve për mbrojtjen e komuniteteve pakicë në vlerë prej 2,000,145.26€, Komuna me numër projektesh por pa shumë të raportuar: Malishevë, Mamushë, Skenderaj.

Në 27 komuna (Deçan; Dragash; Fushë Kosovë; Junik; Gjiilan; Glllogoc, Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Rahovec; Shtime; Shtërpçë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë.) është bërë publikimi i thirrjeve dhe përfituesve në web faqet. Në 3 komuna (Gjakovë; Ranillug; Zveçan.) nuk e kanë bërë. Në 2 Komuna (Mamushë; Pejë.) pjesërisht.

1.3 Lufta kundër korrupsionit dhe kundër terrorizmit

Një ndër objektivat më specifike e cila buron nga Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm është edhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve me qëllim të identifikimit të hershëm të faktorëve dhe proceseve të radikalizmit, andaj më këtë qëllim në 18 komuna (Deçan; Dragash; Junik; Glllogoc, Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Lipjan; Malishevë; Obiliq; Podujevë; Prizren; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë, Mitrovicë e Jugut) në bashkëpunim nivelin qendror dhe donatorë janë organizuar trajnime për zyrtarët komunal të arsimit, mësuesit, dhe menaxhmentin e shkollave për të identifikuar të rinjtë që janë në rrezik për ekstremizëm kurse në 14 komuna (Fushë Kosovë; Gjiilan; Klinë; Mamushë; Novobërdë; Partesh; Pejë; Prishtinë; Rahovec; Ranillug; Shtime; Shtërpçë; Skenderaj; Zveçan.) nuk janë organizuar.

Për mbështetjen dhe parandalimin e terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, 20 komuna kanë ndërmarrë veprime konkrete për vetëdijësimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpijë në ekstremizëm të dhunshëm, si: ligjërata dhe trajnime në shkolla; fushata vetëdijësuese në komunitete; shpërndarje broshurash dhe fletushkash; takime dhe debate me rininë, prindër dhe strukturat arsimore; trajnime për zyrtarë komunalë; bashkëpunim me Policinë e Kosovës, KFOR-in dhe organizata qytetare/ndërkombëtare; diskutime dhe rekomandime përmes KKS-së; krijim i hapësirave të sigurta në shkolla për pyetje private rreth çështjeve


të ndjeshme; dhe aktivitete në terren për identifikim dhe referim të rasteve të rrezikut. Ndërsa 12 komuna (Fushë Kosovë, Hani i Elezit, Klinë, Mamushë, Novobërdë, Partesh, Pejë, Prishtinë, Rahovec, Ranillug, Shtërpçë, Skenderaj) nuk kanë raportuar veprime të tilla për periudhën e raportimit. Në 31 komuna nuk ka pasur asnjë rast të paraqitur në Këshillat Komunal të Sigurisë në Bashkësi lidhur me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, ndërsa 1 Komunë (Gjilan) janë paraqitur 5 raste.

Më qëllim të parandalimit dhe menaxhimit të konflikteve të interesit, gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2025, në 28 komuna nuk është paraqitur asnjë rast i konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal. Në 4 komuna janë raportuar raste: Glogoc — 1 rast; Gjakovë — 1 rast; Klinë — 3 raste; Kamenicë — 5 raste, pra gjithsej 10 raste të paraqitura të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal.

Sa i përket anëtarëve të kuvendit që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend të komunës, në 4 komuna (Novobërdë, Obiliq, Podujevë, Shtime) janë paraqitur 30 raste; në 28 komuna nuk është raportuar asnjë rast i tillë.

Nga të dhënat e pranuar, 28 komuna kanë përgjigjur Po — pra kanë hartuar Planin Lokal për Integritet sipas Ligjit Nr. 03/L-159: Deçan, Dragash, Junik, Gjilan, Glogoc (Drenas), Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpçë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri dhe Kamenicë. 4 komuna kanë përgjigjur Jo — nuk e kanë hartuar planin: Fushë Kosovë, Kaçanik, Mamushë dhe Zveçan.

Pjesa më e madhe e komunave sipas raportimeve e kanë të caktuar zyrtarin që raporton për Planin Lokal të Integritetit nga 32 komuna raportuese 27 komuna kanë koordinators që monitoron dhe raporton lidhur me Planin Lokal për Integritet. 5 komuna nuk kanë koordinators të tillë: Fushë Kosovë, Kaçanik, Mamushë, Ranillug, Zveçan.



Grafikoni 3: Plani Lokal për Integritet dhe zyrtari i caktuar për planin e integritetit

Sa i përket implementimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, për krijimin e qasjes për shërbimin në gjuhët zyrtare janë 25 komuna që janë ndërmarrë masa konkrete për të siguruar qasje dhe shërbime në gjuhët zyrtare; 7 komuna nuk kanë raportuar masa të tilla (Hani i Elezit, Kaçanik, Malishevë, Pejë, Prishtinë, Skenderaj, Zveçan).

Veprimet kryesore të ndërmarra: rekrutim i përkthyesve/zyrtarëve dygjuhësh; përkthim dhe publikim i dokumenteve të Kuvendit dhe akteve komunale në gjuhët zyrtare; përkthim i përmbajtjes së faqes zyrtare dhe njoftimeve; ofrim interpretimi gjatë mbledhjeve publike dhe takimeve; shpërndarje broshurash dhe njoftimesh në gjuhë të ndryshme; trajnime për stafin për përdorimin korrekt të gjuhëve; vendosje tabelash dhe informacionesh publike në gjuhët zyrtare; kontrata për shërbime përkthimi dhe krijim i njësisve/zyrave për përkthime; konsultime me përfaqësues të komuniteteve për nevojat gjuhësore.

1.4 Mbrojtja dhe trashëgimia kulturore

Në fushën e trashëgimisë kulturore sfidë e komunave vazhdon ende të mbetet hartimi i planeve komunale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, pasi që sipas të dhënave nga 32 komuna raportuese janë vetëm 7 komuna (Deçan; Dragash; Junik, Istog; Kaçanik; Prizren; Rahovec.) të cilat kanë hartuar këtë plan.

Sfidat që 25 komuna (Fushë Kosovë; Gjiilan; Glllogoc, Gjakovë; Hani i Elezit; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Pejë; Podujevë; Prishtinë; Ranillug; Shtime; Shtërpçë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Zveçan; Kamenicë.) nuk e kanë miratuar këtë Plan janë: Mungesa e stafit profesional, mungesa e ekspertëve, mungesa e mjeteve buxhetore, sfidat lidhur me regjistrimin dhe dokumentimin e trashëgimisë kulturore ekzistuese etj.

Numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale 12 Komuna (Deçan, Fushë Kosovë, Gjakovë, Istog, Kaçanik, Klinë, Malishevë, Podujevë, Prizren, Shtërpçë, Viti, Kamenicë) janë evidentuar 12 shkelje në zonat e mbrojtura, ndërsa në 20 Komuna (Dragash, Gjiilan, Glllogoc/Drenas, Hani i Elezit, Lipjan, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Prishtinë, Rahovec, Ranillug, Shtime, Skenderaj, Suharekë, Vushtrri, Zveçan, Junik) nuk është raportuar asnjë rast.

Në 9 Komuna (Glllogoc, Hani i Elezit; Kaçanik; Klinë; Partesh; Rahovec; Ranillug; Suharekë; Zveçan) nuk janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të tërësive te objekteve të trashëgimisë kulturore objektet e kultit fetar, zonat e mbrojtura, muzetë, etj, në 12 Komuna (Fushë Kosovë; Junik; Gjiilan; Gjakovë; Istog; Lipjan; Mamushë; Obiliq; Pejë; Podujevë; Prizren; Shtime.) janë siguruar këto pajisje, dhe në 11 Komuna (Deçan; Dragash; Malishevë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Prishtinë; Shtërpçë; Skenderaj; Viti; Vushtrri; Kamenicë.) janë siguruar pjesërisht.

Sa i përket nënshkrimit të Memorandumeve të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse (vetëm komunat që kanë objekte kishtare), në 24 komuna ka objekte kishtare; nga këto, 7 komuna (Istog, Klinë, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Prizren, Kamenicë) kanë nënshkruar Memorandume; 17 komuna (Deçan, Fushë Kosovë, Kaçanik, Lipjan, Mitrovicë e Jugut, Partesh, Podujevë, Prishtinë, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpçë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Zveçan) nuk kanë nënshkruar Memorandume; 8 komuna nuk kanë objekte kishtare ortodokse (Dragash, Gjiilan, Glllogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Malishevë, Mamushë, Junik).

Për funksionimin e Këshillit të fshatit për Hoqën e Madhe, Kuvendi I komunës së Rahovecit me datën 28.02.2022 ka marrë vendim për iniciimin e themelimit të këtij këshilli.

Për zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, për periudhën Janar - Dhjetor 2025 komuna e Prizrenit ka marrë këto veprime: Respektimi i Planit të Konservimit dhe Ligjit për Trashëgimi Kulturor.

Secila lëndë që parashtrohet në DUPH që gjendet në kuadër të Ligjit për Qendrën Historike dërgohet në QRTK dhe në KTKP (Këshilli për Trashëgimi Kulturor-Prizren) për të marrë vendim dhe rekomandimin e tyre. Respektimi i Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit-Zona e Parë e Mbrojtjes së dhe respektimit i Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit.

Në Komunën e Fushë Kosovës nuk është bërë themelimi Muzeut të Natyrës.

Gjithashtu me qëllim për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore komunat kanë ndërmarrë këto aktivitete: Promovimi i aseteve të trashëgimisë në media televizive, Postimit e fotografive nga asetet e trashëgimisë kulturore, Është bërë projekti për restaurimin e disa objekteve të trashëgimisë kulturore, Pastrimi i qytetit, shpërndarja e broshurave, vetëdijësimi i qytetarëve, restaurimeve, aktiviteteve edukative, ekspozitave dhe projekteve kulturore, hartimi i hartave zonale dhe broshurave për promovim të turizmit, vizita të ndryshme në objektet që janë nën mbrojtje etj.

2. KRITERET EKONOMIKE

2.1 Ekzistenca e ekonomisë funksionale e tregut

Për ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët është paraparë krijimi i qendrave për regjistrimin e bizneseve (one stop shop-et) të cilat lehtësojnë ofrimin e shërbimeve për biznese përfshirë regjistrimet e tyre, në 29 komuna janë funksionale, ndërsa në 3 Komuna (Partesh; Prishtinë; Ranillug) nuk janë themeluar.

Numri i inspektorëve të tregut në 27 komuna është 70, ndërsa janë 4 Komuna (Novobërdë; Pejë; Shtërpçë; Zveçan.) nuk kanë inspektor dhe Komuna e Prishtinës ka theksuar se që nuk është kompetencë e Komunës. Gjithashtu numri i inspektimeve në 25 komuna është 4,405 inspektime, ndërsa 7 Komuna (Mamushë; Novobërdë; Partesh; Pejë; Prishtinë; Shtërpçë; Zveçan.) nuk ka pasur inspektime.

Sa i përket dëgjimeve publike për planifikimin e buxhetit në 27 komuna janë mbajtur 274 dëgjime publike, kurse në 5 komuna (Deçan; Mamushë; Pejë; Ranillug; Shtime.) nuk janë mbajtur.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025 në 29 Komuna numri i bizneseve të regjistruara është 7,124 biznese. Ndërsa numri i bizneseve të mbyllura në 27 Komuna është 839 biznese, në 3 Komuna (Partesh, Ranillugë Zveçan) nuk ka pasur të dhëna. Një ndër aktivitetet që kanë rëndësi në agjendën Evropiane është edhe mbështetja e grave në udhëheqjen e bizneseve, e që gjatë vitit 2025 numri i bizneseve të udhëhequra nga gratë në 28 Komuna (Deçan; Dragash; Fushë Kosovë; Junik; Gjilan; Glllogoc; Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Pejë; Podujevë; Prizren; Rahovec; Shtime; Shtërpçë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë.) është 2,402 biznese, ndërsa në 3 Komuna

(Mamushë, Ranillug, Zveçan) nuk ka biznese të udhëhequra nga gratë; për Prishtinë nuk ka informatë të siguruar.

Buxheti i ndarë në 19 Komuna (Dragash; Fushë Kosovë; Gjiilan; Glllogoc; Gjakovë; Hani i Elezit; Kaçanik; Lipjan; Malishevë; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Pejë; Podujevë; Prizren; Rahovec; Shtime; Skenderaj; Viti; Kamenicë.) për subvencionimin e bizneseve është 2,512,422.60 €, ndërsa në 13 Komuna (Deçan; Junik; Istog; Klinë; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Prishtinë; Ranillug; Shtërpcë; Suharekë; Vushtrri; Zveçan.) nuk kanë ndarë buxhet për subvencionimin e bizneseve gjatë periudhës raportuese.

2.2 Tatimet

Me qëllim të luftimit të ekonomisë jo formale në 24 komuna janë ndërmarr veprime si: *kontrollat e vazhdueshme tek bizneset lidhur me lëshimin e kuponëve fiskal, Mbyllja e subjekteve ilegale deri në kompletimin e dokumentacionit adekuat për ushtrimin e veprimtarisë, Obligimi i bizneseve për tu regjistruar pranë ARBK, produkteve të cilat kanë qenë pa deklaracion në gjubën zyrtare janë larguar nga shitja kurse produktet që kanë qenë pa origjinë janë sekuestruar dhe asgjësuar në prani të personave që kanë bërë tregtimin e tyre në mënyrë të pa ligjshme, vërejtje, inspektime mbi posedimin certifikatave të regjistrimit të bizneseve, inspektim dhe kontrole të vazhdueshme të lokaleve afariste, mbyllja e subjekteve ilegale, ofrimi i këshillave të nevojshme për të operuar ligjshëm* etj ndërsa në 8 komuna (Hani i Elezit; Mamushë; Novobërdë; Prishtinë; Skenderaj; Zveçan; Ranillug; Shtërpcë) nuk është ndërmarr asnjë veprim.

Gjatë periudhës vitit 2025, nga 32 komuna raportuese 26 prej tyre kanë pranuar 305 rekomandime nga Auditori i Përgjithshëm, Komunitat të cilat kanë rekomandime janë (Deçan 7; Dragash 6; Fushë Kosovë 15; Junik 3; Gjiilan 14; Glllogoc 11; Gjakovë 10; Kaçanik 14; Klinë 8; Lipjan 15; Malishevë 24; Mamushë 3; Mitrovicë e Jugut 13; Novobërdë 15; Obiliq 9; Partesh 5; Podujevë 13; Prishtinë 27; Prizren 12; Rahovec 6; Shtime 8; Shtërpcë 11; Skenderaj 11; Viti 13; Vushtrri 27; Kamenicë 5) ndërsa Komuna pa rekomandime janë 2 (Istog, Suharekë) dhe 4 Komuna nuk kanë siguruar të dhëna (Hani i Elezit, Pejë, Ranillug, Zveçan). Prej tyre të adresuar janë 174 rekomandime, të pa adresuara mbesin 88 rekomandime dhe 146 rekomandime gjenden në proces.

Njësia e Auditimit të Brendshëm është e funksionalizuar në 27 komuna dhe ka 48 zyrtarë, ndërsa 4 komuna (Hani i Elezit; Mamushë; Partesh; Zveçan.) nuk funksionon, Komunitat pa përgjegje (Pejë).

Në 25 Komuna (Përmbledhje: Themelimi i komitetit për auditim të brendshëm është bërë në 25 komuna Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjiilan, Glllogoc/Drenas, Gjakovë, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Kamenicë) është themeluar komiteti për auditim të brendshëm, ndërsa në 6 Komuna (Hani i Elezit, Istog, Mamushë, Novobërdë, Partesh, Zveçan) nuk është themeluar. Komuna Pejë nuk ka dhënë përgjigje.

Sa i përket planifikimit të pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal, janë 26 komuna të cilat kanë publikuar regjistrin e pronës komunale, ndërsa në 6 komuna (Mamushë; Novobërdë; Ranillug; Viti; Zveçan, Pejë) nuk është publikuar.

2.3 Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë

Në 19 komuna është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike, në 13 Komuna (Gjilan; Gjakovë; Hani i Elezit; Klinë; Mamushë; Novobërdë; Obiliq; Prishtinë; Prizren; Vushtrri; Zveçan; Kamenicë; Pejë) nuk është bërë ende funksionalizimi i zonave ekonomike.

3. STANDARDET EVROPIANE

3.1 Bujqësia dhe zhvillimi rurale

Në sektorin e bujqësisë sfidë e theksuar mbetet hartimi i dokumenteve për rregullimin e mëtejshëm të tokave bujqësore pasi që nga 32 Komuna raportuese vetëm në 12 komuna (Dragash; Junik; Glogoc; Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Malishevë; Partesh; Podujevë; Prizren; Rahovec; Shtime) është hartuar Plan Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, ndërsa në 20 komuna (Deçan; Fushë Kosovë; Gjilan; Kaçanik, Klinë; Lipjan; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Pejë; Prishtinë; Ranillug; Shtërpcë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Zveçan; Kamenicë) ende nuk është hartuar Plan Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Gjatë periudhës raportuese janë parashtruar gjithsej 489 kërkesa për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në 26 komuna të Kosovës: Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Glogoc, Gjakovë, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpcë, Skenderaj, Viti, Kamenicë

Në 6 komuna — Hani i Elezit, Mamushë, Obiliq, Suharekë, Vushtrri, Zveçan — nuk është raportuar asnjë kërkesë për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.

Vendimet e miratuara për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore janë miratuar në 23 komuna Deçan (9); Fushë Kosovë (34); Junik (1); Gjilan (55); Glogoc (27); Gjakovë (44); Istog (3); Kaçanik (40); Lipjan (53); Malishevë (3); Partesh (7); Pejë (9); Podujevë (17); Prishtinë (38); Prizren (2); Rahovec (5); Ranillug (2); Shtime (13); Shtërpcë (1); Skenderaj (2); Viti (8); Kamenicë (1); ndërsa nuk ka vendime të miratuara në 9 komuna (Dragash; Hani i Elezit; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Suharekë; Vushtrri; Klinë, Zveçan). Numri total i vendimeve të miratuara është 374.

Nga të dhënat e mbledhura, 19 komuna raportuan se kanë raste të humbjes së tokës bujqësore: Fushë Kosovë, Junik, Gjakovë, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Mamushë, Novobërdë, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtërpcë, Skenderaj, Suharekë dhe Kamenicë. 10 komuna deklaruan se nuk kanë raste: Deçan, Dragash, Gjilan, Hani i Elezit, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Partesh, Viti dhe Zveçan. Për 3 komuna nuk ka informacion të plotë në përgjigje (Glogoc, Shtime, Vushtrri nuk dha të dhëna). Ky shpërndarje tregon një përqendrim të konsiderueshëm të rasteve në disa komuna dhe mungesë të informacionit për disa të tjera.

Në komunat të cilat ka pasur raste të humbjes së tokës bujqësore shumica e komunave kanë ndërmarrë masa të kombinuara për të mbrojtur tokat bujqësore: inspektime dhe zbatim ligjor, rregullim të shtratit të lumenjve dhe kanaleve të ujitjes, fushata informuese, ndalime të ndërtimeve pa leje dhe planifikim hapësinor. Disa

komuna raportuan veprime konkrete infrastrukturore (kanale, betonime, rregullime shtretërisht), ndërsa të tjera përqendrohen në kontroll administrativ dhe këshillim.

Lidhur me konsolidimin e mëtejshëm të qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural, në 27 komuna (Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Glogoc, Gjakovë, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpçë, Suharekë, Viti, Vushtrri, Kamenicë) janë funksionalizuar këto qendra. Në 5 komuna (Hani i Elezit, Partesh, Podujevë, Skenderaj, Zveçan) nuk janë funksionalizuar.

Për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe promovimin e rëndësisë së bujqësisë, në 27 komuna (Deçan, Dragash, Fushe Kosove, Gjilan, Glogoc, Gjakove, Hani I Elezit, Kaçanik, Kline, Lipjan, Malisheve, Mamushë, Mitrovice Juge, Obiliq, Partesh, Peje, Podujeve, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpçë, Skenderaj, Suhareke, Viti, Kamenice) është ofruar mbështetje për 9,454 fermerë në sektorët e bletarisë, blegtorisë, perimtarisë, pemëtarisë, bimëve foragjere dhe hortikulturës; për komunën e Kamenicës është raportuar se ka mbështetje, por numri i fermerëve nuk është dhënë në të dhënat e pranuar. Ndërkaq, 5 komuna (Junik, Istog, Novobërdë, Vushtrri, Zveçan) nuk kanë raportuar mbështetje për fermerët gjatë periudhës raportuese.

Planin për Menaxhimin e tokave rurale e posedojnë 10 komuna (Dragash, Hani i Elezit, Istog, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Ranillug, Shtime, Viti). Në 22 komuna (Deçan, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Glogoc, Gjakovë, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Prizren, Rahovec, Shtërpçë, Skenderaj, Suharekë, Vushtrri, Zveçan, Kamenicë.) nuk është hartuar.

3.2 Energjia

Me qëllim të zbatimit të obligimeve të dala nga MSA, komunat kanë avancuar politikat e efijencës së energjisë. Planin për Efijencë të Energjisë e kanë miratuar 18 komuna: Deçan, Dragash, Junik, Gjilan, Glogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Malishevë, Mamushë, Obiliq, Partesh, Prizren, Rahovec, Shtime, Shtërpçë, Suharekë, Viti; ndërsa në 14 komuna (Fushë Kosovë, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Ranillug, Skenderaj, Vushtrri, Zveçan, Kamenicë) ky plan ende nuk është hartuar.


Me qëllim të zbatimit të Planit për Efijencë të Energjisë, komunat kanë nisur një sërë projektsh konkrete për përmirësimin e performancës energjetike të objekteve publike dhe infrastrukturës. Nga të dhënat e dhëna, 22 komunat Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Glogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Suharekë, Viti dhe Kamenicë kanë raportuar aktivitete konkrete (renovime, vendosje panele diellore, ndriçim LED, izolime, etj.).

Ndërkaq, 10 Komunat Klinë, Mamushë, Novobërdë, Partesh, Pejë, Ranillug, Skenderaj, Shtërpçë, Vushtrri dhe Zveçan nuk kanë pasur aktivitete të përmendura në të dhëna.

3.3 Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Me qëllim të forcimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në nivel komunal, zyrtari përkatës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është emëruar në 28 komuna: Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Junik, Gjilan, Glllogoc, Gjakovë, Hani i Elezit, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Partesh, Podujevë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpçë, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Kamenicë. Në 4 komuna nuk është emëruar zyrtari përkatës: Novobërdë, Pejë, Prishtinë, Zveçan.

Sa i përket zyrarit për barazi gjinore është caktuar në 30 komuna (Deçan; Dragash; Fushë Kosovë; Junik; Gjilan; Glllogoc, Gjakovë; Hani i Elezit; Istog; Kaçanik; Klinë; Lipjan; Malishevë; Mamushë; Mitrovicë e Jugut; Novobërdë; Obiliq; Partesh; Pejë; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Rahovec; Shtime; Shtërpçë; Skenderaj; Suharekë; Viti; Vushtrri; Kamenicë.), ndërsa në 2 komuna (Ranillug; Zveçan.) nuk është emëruar zyrtari përkatës.



Grafikoni 5: Caktimi i zyrarëve për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe barazi gjinore

